**V E N D I M**
**PËR**

**KRYERJEN E PAGESËS SË DOZAVE TË VAKSINAVE, QË RRJEDH NGA MARRËVESHJA, NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN E INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR "KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET", A.Ş**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të pagesës së dozave të vaksinave anticovid-19, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret", A.Ş, të miratuar me aktin normativ nr.22, datë 21.5.2021, të Këshillit të Ministrave.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, për Institutin e Shëndetit Publik, në llogarinë ekonomike 6050000 (Produkti 91305AH) të programit të shëndetit publik (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë (sipas kursit zyrtar të këmbimit në datën e pagesës) i shumës 10 000 000 (dhjetë milionë) USD, të pagesës së dozave të vaksinave anticovid-19, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin e Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret", A.Ş, të miratuar me aktin normativ nr.22, datë 21.5.2021, të Këshillit të Ministrave.

3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**Vendime të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, datë 16 Qershor 2021**